



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4126 Prot.

Tiranë, më 30.06. 2023

U D H Ë Z I M

Nr. 12, datë 30.06. 2023

“PËR  
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E  
ARSIMIT TË LARTË”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU I

PORTALET E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT

1. Portali matura shtetërore *online* është sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të administrojë:
  - a) Procedurat e aplikimit me formularët A1 dhe A1Z të kandidatëve të maturës shtetërore, përfshirë kandidatët nga Kosova;
  - b) digjitalizimin e rezultateve të provimeve të maturës shtetërore;
  - c) prodhimin e diplomës së maturës shtetërore.
2. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (në vijim SMIP) është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të kryejë:
  - a) Procesin e regjistrimit dhe administrimit të rezultateve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë të kandidatëve, që kanë plotësuar formularin e aplikimit A1 ose A1Z në portalin matura shtetërore *online*;
  - b) ndërveprimin me portalin U-Albania nëpërmjet përcjelljes në RASH të bazës së plotë të të dhënave të kandidatëve përfshirë kandidatët nga Kosova aplikues me formularët A1/A1Z;
  - c) prodhimin e certifikatës së maturës shtetërore.
3. Portali U-Albania është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të kryejë procedurat e mëposhtme:
  - a) Informimin e kandidatëve përfshirë ata nga Kosova për programet e studimit që ofrojnë IAL-të për çdo vit akademik, në mënyrë të detajuar si më poshtë:
    - i) Kriteret e pranimit;
    - ii) kuotat e pranimit;
    - iii) programet mësimore, kurrikulat etj.

- b) Procesin e përzgjedhjes nga kandidatët të preferencave në programet e studimeve me karakter profesional, programet e studimit të ciklit të parë të studimeve dhe/ose programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, të shpallura nga IAL-të.
  - c) Përcjelljen IAL-ve të bazës së plotë të të dhënave të maturantëve/kandidatëve, përfshirë kandidatët nga Kosova që kanë përzgjedhur programet e studimit që këto IAL ofrojnë.
  - d) Procesin e shpalljes së listave renditëse të kandidatëve në rang kombëtar sipas renditjes dhe përlllogaritjes së pikëve nga IAL-të.
  - e) Procesin e regjistrimit dhe të çregjistrimit të studentëve nga IAL-të për programet e studimeve me karakter profesional, për programet e ciklit të parë të studimeve dhe/ose programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, të shpallura nga IAL-të.
  - f) Sinkronizimin e regjistrimeve sipas çdo IAL-je në rang kombëtar dhe lëvizjen e vijës së kuqe në listën renditëse të kandidatëve.
  - g) Dhënien *online* të informacioneve të nevojshme për kandidatët për ndjekjen në mënyrë dinamike, përgjatë raundit të parë dhe raundit të dytë, të procesit të shpalljes së fituesve.
4. Aplikimi i kandidatëve përfshirë ata nga Kosova, me formularët A1 dhe A1Z bëhet në portalin e maturës shtetërore *online* [www.matura.qsha.gov.al](http://www.matura.qsha.gov.al), për programet e studimeve me karakter profesional, për programet e ciklit të parë të studimeve, për programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve dhe programet e dyta të studimit që nuk janë të të njëjtit cikël studimi me programin e parë të studimeve që ka përfunduar kandidati, në institucionet e arsimit të lartë.
  5. Hedhja e rezultateve lëndore të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, për maturantët/kandidatët që kanë plotësuar *online* formularin A1 ose A1Z, bëhet nga drejtoritë e institucioneve arsimore në sistemin SMIP, ndërsa për kandidatët nga Republika e Kosovës hedhja e rezultateve bëhet nga institucioni arsimor parauniversitar, i përcaktuar nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, pas njohjes dhe njehsimit të diplomës dhe rezultateve nga QSHA.
  6. Për kandidatët, që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit dhe që kanë aplikuar me formularin A1 dhe A1Z, drejtoritë e institucioneve arsimore përkatëse, të caktuar nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, nga ku ata kanë kryer aplikimin, hedhin në sistemin SMIP, të dhënat e lidhura me rezultatet e njehsuara të shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë.
  7. Për kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në vitet e mëparshme dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, drejtoritë e institucioneve arsimore, ku ata kanë kryer aplikimin, hedhin në sistemin SMIP, të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë.
  8. Përzgjedhja e programeve të studimeve me karakter profesional, të ciklit të parë të studimeve si dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, të ofruara nga IAL-të për vitin akademik përkatës, bëhet në portalin e aplikimit universitar U-Albania <https://ualbania.al/>.
  9. Regjistrimi i kandidatëve fitues, të shpallur nga IAL-të kryhet nga sekretaritë mësimore dhe pasqyrohet në portalin e aplikimit universitar U-Albania <https://ualbania.al/>.
  10. MAS i përcjell zyrtarisht QSHA-së dhe RASH-it listën e programeve të studimit me karakter profesional, programeve të ciklit të parë të studimeve, të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe numrin e kuotave të pranimit për secilin program studimi.



**KREU II**  
**PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE NË**  
**PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, NË**  
**PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE DHE NË**  
**PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË**

**A. PROCEDURAT E APLIKIMIT, RAUNDI I PARË**

1. Kandidatët, përfshirë kandidatët nga Kosova (në vijim kandidatët) për ndjekjen e studimeve në IAL, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, duhet të kryejnë procesin e aplikimit *online* në portalin e aplikimit universitar U-Albania.
2. Aplikimi kryhet nga kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:
  - a) janë pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të arsimit të mesëm të lartë;
  - b) plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave;
  - c) plotësojnë kriteret shtesë të përcaktuara nga IAL-të për programet e studimit për të cilat aplikojnë;
  - d) nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.
3. Përjashtimisht, kandidatët, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, me notë mesatare sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, aplikojnë në programet e studimit të ciklit të parë, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë, master në fushën e mësuesisë, duke konfirmuar në rubrikat e aplikimit dakordësinë për mosndjekjen e këtyre programeve në ciklin e dytë dhe pajisen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore me numër të veçantë matrikullimi, i cili nuk i lejon të ndjekin më pas, programet e ciklit të dytë, master në fushën e mësuesisë.
4. Kandidatët, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dy mijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim të cilën e shkarkojnë në portalin U-Albania. Periudha e kryerjes së pagesës dhe afati i dorëzimit të mandatit të pagesës si dhe konfirmimi në portalin U-Albania nga sekretaritetë e shkollave, përcaktohen në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik (në vijim kalendarit).
5. Sipas kalendarit, kandidatët që duan të ndjekin studimet në IAL, përfshirë edhe kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, pas pagesës së tarifës së aplikimit, do të aplikojnë në portalin U-Albania nëpërmjet formularit *online* të aplikimit, mbi bazën e notës mesatare sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për kriterin e notës mesatare dhe kritereve të tjera të përcaktuara nga IAL-të.
6. Kandidatët zgjedhin deri në 10 (dhjetë) programe studimi nga lista e programeve të studimit, që ofrohen nga IAL-të, për vitin akademik përkatës.

7. Drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (në vijim DRAP/ZVAP) duhet të marrin masa për krijimin e kushteve për t'iu ofruar kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar, lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.

**B. PËRCJELLJA E TË DHËNAVE DHE REZULTATEVE, PROCESI I PËRLLOGARITJES SË PIKËVE DHE PUBLIKIMI I LISTAVE TË KANDIDATËVE, RAUNDI I PARË.**

1. Sipas kalendarit, QSHA i përcjell RASH, në formë elektronike dhe zyrtarisht, listën e maturantëve/kandidatëve që kanë aplikuar me formularët A1/A1Z me të dhënat si më poshtë:
  - a) ID e maturës;
  - b) të dhënat personale dhe të dhëna shkollore (shkolla, DRAP/ZVAP, llojin e formularit);
  - c) indeksat e llojeve të institucioneve të arsimit të mesëm të lartë.
2. Sipas kalendarit, QSHA i përcjell RASH, në formë elektronike dhe zyrtarisht, për çdo kandidat të dhënat sa më poshtë:
  - a) ID e maturës;
  - b) të dhënat personale dhe të dhënat shkollore (shkolla, DRAP/ZVAP/llojin e formularit);
  - c) notat e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë ;
  - d) rezultatet e provimeve të maturës shtetërore;
  - e) mesataren e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
  - f) mesataren e provimeve të maturës shtetërore;
  - g) mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për kriterin e notës mesatare;
  - h) indeksat e llojeve të institucioneve të arsimit të mesëm të lartë .
3. IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi shkarkojnë sipas kalendarit nga Portali U-Albania listën e kandidatëve që konkurrojnë në programet përkatëse të studimit.
4. Në datën e përcaktuar në kalendar, IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi, afishojnë në mjediset e tyre dhe në faqet zyrtare elektronike përkatëse, listat e kandidatëve. Konkursat e pranimit do të zhvillohen në periudhën e përcaktuar në kalendar.
5. Në datën e përcaktuar në kalendar, IAL-të mund të shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:
  - a) Listën e kandidatëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;
  - b) notat e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
  - c) rezultatet e provimeve të maturës shtetërore;
  - d) mesataren e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
  - e) mesataren e provimeve të maturës shtetërore;
  - f) mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për kriterin e notës mesatare;
  - g) indeksat e llojeve të institucioneve të arsimit të mesëm të lartë.
6. IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, pas kryerjes së përllogaritjes së pikëve për çdo kandidat, sipas kriterëve të pranimit të përcaktuara me vendim të Senatit Akademik, si dhe renditjes së tyre në varësi të pikëve të grumbulluara, afishojnë në mjediset



publike, si dhe në faqet e tyre zyrtare listat e renditjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe në listë, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

7. Brenda datës së përcaktuar në kalendar, IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së kandidatëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID e tyre të maturës, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës së përcaktuar në kalendar, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

### **C. PROCESI I REGJISTRIMIT, RAUNDI I PARË**

1. Kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë dhe janë shpallur fitues, kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretariatë mësimore të IAL-ve në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.
2. Periudha e regjistrimit është e ndarë në 7 (shtatë) faza 48-orëshe, sipas afateve të përcaktuara në kalendar. Kandidati ndjek në portalin U-Albania ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në një apo disa programe studimi, nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.
3. Kandidati i shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse kandidati nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në atë program studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë.
4. Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 7 (shtatë) fazave 48-orëshe MAS dhe RASH publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare: [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al) dhe <https://ualbania.al/>.
5. Procesi i regjistrimeve nga sekretariatë mësimore, me dokumentacion dhe *online*, vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të pranimit në programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e fituesve të raundit të parë.
6. Në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe në listë dhe shpallen fitues të rinj, të cilët regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Këto faza vijnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën e përcaktuar në kalendar. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara, të cilat nuk kanë kandidatë në pritje, do të rikthehen kandidatët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi kryhet sipas listës së renditjes së kandidatit për raundin e parë.
7. Brenda datës të përcaktuar në kalendar, RASH përcjell në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të parë bashkë me kuotat e paplotësuara në format shkresor dhe elektronik me informacionet si më poshtë:
  - a) IAL;
  - b) njësia kryesore e IAL-së;
  - c) cikli i studimit;
  - d) programi i studimit;
  - e) data e regjistrimit;
  - f) ID e maturës;
  - g) të dhënat personale të kandidatit të regjistruar.

8. Kandidatët fitues në një program studimi, të cilët nuk janë regjistruar sipas afateve të raundit të parë, humbasin të drejtën për t'u regjistruar në këtë raund, por kanë të drejtën që të plotësojnë formularin e aplikimit të raundit e dytë.

#### **D. PROCESI I ÇREGJISTRIMIT, RAUNDI I PARË**

1. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistrin e IAL-së, ka të drejtë të çregjistrohet në datat e përcaktuara në kalendar. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda këtij afati, ai nuk ka të drejtë të çregjistrohet me qëllim regjistrimin në një program tjetër studimi ku është shpallur fitues për atë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania nga sekretaria mësimore e fakultetit.
2. Sekretaritë mësimore, në përfundim të procesit të çregjistrimit të kandidatëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, përcjellin në portalin U-Albania listën e kandidatëve të çregjistruar në format elektronik, sipas përcaktimeve në kalendar.

#### **E. PROCESI I ANKIMIT, RAUNDI I PARË**

1. Kandidati ka të drejtën e ankimit në IAL-të përkatëse në datën e përcaktuar në kalendar. Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesës, IAL duhet të shprehet me vendim lidhur me ankimin.
2. IAL, pas përfundimit të afatit të ankimit dhe shqyrtimit të ankesave, pasqyrojnë në format elektronik në portalin U-Albania, brenda datës së përcaktuar në kalendar, vendimet lidhur me ankimet e kandidatëve.
3. Kandidati, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse është shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, vijon procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa është pranuar, ai duhet të çregjistrohet nga programi i studimit (nëse është regjistruar) dhe të regjistrohet në datat e përcaktuara në kalendar në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimi.
4. Kuotat e paplotësuara, në përfundim të raundit të parë për çdo program studimi, mund të përshtaten nga IAL-ja në programe të tjera studimi të të njëjtit cikël, të ofruara brenda së njëjtës njësi kryesore, pa kaluar totalin e kuotave për njësi kryesore. IAL njofton zyrtarisht MAS për vendimin e Senatit Akademik mbi përshtatjen e kuotave të programeve të studimit, jo më vonë se 3 (tri) ditë pune nga data e përfundimit të afatit për çregjistrim për raundin e parë. Në rast se përshtatja e kuotave është sipas përcaktimeve ligjore, MAS njofton IAL-në, RASH dhe QSHA, për konfirmimin e përshtatjes së kuotave para fillimit të periudhës së aplikimit për raundin e dytë.

#### **F. PROCEDURAT E APLIKIMIT, RAUNDI I DYTË**

1. Në periudhën e caktuar në kalendar, kryhet procesi i aplikimit *online* për raundin e dytë në Portalin U-Albania. Kanë të drejtë të aplikojnë, duke përzgjedhur deri në 10 (*dhjetë*) programe studimi, kandidatët, përfshirë edhe kandidatët nga Kosova, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe rezultojnë kalues në provimet e maturës shtetërore, por që:
  - a) nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë;



- b) kanë kryer procesin e aplikimit *online* në raundin e parë dhe nuk janë shpallur fitues;
  - c) kanë kryer procesin e aplikimit *online* në raundin e parë dhe nuk kanë arritur të regjistrohen;
  - d) janë çregjistruar pas përfundimit të raundit të parë.
2. Drejtoritë e institucioneve të arsimit të mesëm të lartë, për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar me formularin A1 dhe A1Z, hedhin në sistemin SMIP të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, deri në datën e përcaktuar në kalendar.
  3. DRAP/ZVAP-të të marrin masa për krijimin e kushteve për t'i ofruar kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.
  4. Kandidatët, që nuk kanë aplikuar në raundin e parë, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dy mijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim, të cilën e shkarkojnë në portalin U-Albania. Kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë dhe do të riaplikojnë në raundin e dytë, nuk duhet të kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për këtë raund. Periudha e kryerjes së pagesës, afati i dorëzimit të mandatit të pagesës, si dhe konfirmimi në portalin U-Albania nga sekretaritë e shkollave, përcaktohen në kalendar.
  5. IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, pas kryerjes së përlllogaritjes së pikëve për çdo kandidat, sipas kriteve të pranimit të përcaktuara nga IAL me vendim të Senatit Akademik, si dhe renditjes së tyre në varësi të pikëve të grumbulluara, afishojnë listat e renditjes në mjediset publike dhe i publikojnë në faqen zyrtare. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe në listë, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.
  6. Brenda datës së përcaktuar në kalendar, IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së kandidatëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID e tyre të maturës, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës së përcaktuar në kalendar, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

## **G. PËRCJELLJA E TË DHËNAVE DHE REZULTATEVE, PROCESI I PËRLLOGARITJES SË PIKËVE DHE PUBLIKIMI I LISTAVE TË KANDIDATËVE, RAUNDI I DYTË**

1. Sipas afatit të përcaktuar në kalendar QSHA i përcjell RASH, në formë shkresore dhe elektronike, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre si më poshtë:
  - a) ID e maturës;
  - b) të dhënat personale dhe të dhënat shkollore (shkolla, DRAP/ZVAP, lloji i formularit);
  - c) notat e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
  - d) rezultatet e provimeve të maturës shtetërore;
  - e) mesataren e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
  - f) mesataren e provimeve të maturës shtetërore;
  - g) mesataren e përgjithshme të përlllogaritur sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për kriterin e notës mesatare;
  - h) indekset e llojeve të institucioneve arsimore parauniversitare të arsimit të mesëm të lartë.
2. Në datën e përcaktuar në kalendar IAL-të shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre si më poshtë:



- a) listën e kandidatëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;
  - b) numrin personal të kandidatit;
  - c) notat e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
  - d) rezultatet e provimeve të maturës shtetërore;
  - e) mesataren e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
  - f) mesataren e provimeve të maturës shtetërore;
  - g) mesataren e përgjithshme të përlogaritur sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për kriterin e notës mesatare;
  - h) indekset e llojeve të institucioneve arsimore parauniversitare të arsimit të mesëm të lartë.
3. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë, kryejnë procesin e përlogaritjeve të pikëve për çdo kandidat, sipas kriterëve të pranimit të përcaktuara nga IAL me Vendim të Senatit Akademik. IAL për çdo program studimi që ofron, publikon listat e kandidatëve të renditur dhe formulën/mënyrën e përlogaritjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe në listë, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.
4. Brenda datave të përcaktuara në kalendar, IAL afishon dhe publikon listat e renditjes së kandidatëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe ngarkon një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

## **H. PROCESI I REGJISTRIMIT, RAUNDI I DYTË**

1. Kandidatët që kanë aplikuar në raundin e dytë dhe janë shpallur fitues, kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretariatë mësimore të IAL-ve në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.
2. Periudha e regjistrimit është e ndarë në 5 (pesë) faza 48-orëshe, sipas afateve të përcaktuara në kalendar. Secili kandidat ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në një apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.
  1. Kandidati i shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse kandidati nuk regjistrohet brenda afatit 48 orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit në atë program studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë.
  2. Nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe dhe kandidatët kanë të drejtën e regjistrimit, gjatë gjithë periudhës së regjistrimeve të raundit të dytë, për programet e studimit, për të cilat nuk përcaktohen kriteret shtesë nga IAL-ja përkatëse, me përjashtim të notës mesatare dhe numri i kandidatëve është i njëjtë apo më i ulët se numri i kuotave të miratuara;
  3. Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 5 (pesë) faza 48-orëshe MAS dhe RASH-i publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al) dhe në portalin U-Albania <https://ualbania.al/>
  4. Procesi i regjistrimeve nga sekretariatë mësimore, me dokumentacion dhe *online* vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listën e raundit të dytë. Në rast se, pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj, të cilët regjistrohen në fazën pasardhëse. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara të cilat nuk kanë kandidatë në pritje, rikthehen kandidatët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të



cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi kryhet sipas listës së renditjes së kandidatëve për raundin e dytë.

5. Sipas afatit të përcaktuar në kalendar, RASH përcjell në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të dytë në format shkresor dhe elektronik, me informacionet si më poshtë:
  - a) IAL;
  - b) njësia kryesore e IAL-së;
  - c) cikli i studimit;
  - d) programi i studimit;
  - e) data e regjistrimit;
  - f) ID e maturës;
  - g) të dhënat personale të kandidatit të regjistruar.
6. Kandidati, i cili ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.

### **I. PROCESI I ÇREGJISTRIMIT, RAUNDI I DYTË**

1. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistrin e IAL-së, ka të drejtë të çregjistrohet në datat e përcaktuara në kalendar. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda këtij afati, ai nuk ka të drejtë të çregjistrohet me qëllim regjistrimin në një program tjetër studimi ku është shpallur fitues për atë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania nga sekretaria mësimore e fakultetit.
2. Sekretaritetë mësimore, në përfundim të procesit të çregjistrimit të kandidatëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, përcjellin në portalin U-Albania listën e kandidatëve të çregjistruar në format elektronik, sipas përcaktimeve në kalendar.

### **J. PROCEDURA E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PAS PËRFUNDIMIT TË RAUNDIT TË DYTË**

1. Pas përfundimit të raundit të dytë, IAL-të brenda 5 ditëve, përcaktojnë me vendim të Senatit Akademik, programet e studimit që nuk aktivizohen në atë vit akademik për shkak se nuk plotësojnë numrin minimal të studentëve të regjistruar për aktivizimin e programit sipas parashikimeve në aktet e brendshme të IAL-ve. Vendimi i njoftohet ministrisë përgjegjëse për arsimin, QSHA-së dhe studentëve të regjistruar në këto programe, afishohet në mjediset e tyre dhe publikohet në faqen e tyre zyrtare. Sekretaritetë mësimore kryejnë çregjistrimin e këtyre studentëve në datën e përcaktuar në kalendar.
2. Kandidatët e çregjistruar sipas pikës 1 dhe kandidatët që janë pjesë e portalit U-albania që rezultojnë të pa regjistruar në një program studimi, kanë të drejtën e regjistrimit në programe studimi ku ka kuota të pa paplotësuar në të gjitha IAL-të, pavarësisht aplikimeve në raundet e mëparshme, mbi bazën e notës mesatare sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, mbi kriterin e notës mesatare dhe kriterëve të tjera të përcaktuara nga IAL-të, sipas afatit të përcaktuar në kalendar.

3. Sipas afatit të përcaktuar në kalendar, RASH përcjell në QSHA regjistrimet përfundimtare në format shkresor dhe elektronik me informacionet si më poshtë:
  - a) IAL;
  - b) njësia kryesore e IAL-së;
  - c) cikli i studimit;
  - d) programi i studimit;
  - e) data e regjistrimit;
  - f) ID e maturës;
  - g) të dhënat personale të kandidatit të regjistruar.
4. Kandidatët, të cilët kanë bërë regjistrimin me dokumentacion dhe kanë nënshkruar në regjistër, nuk kanë të drejtë të ndryshojnë programin e studimit, për atë vit akademik.

### **KREU III DOKUMENTACIONI PËR REGJISTRIM**

1. Kandidatët fitues duhet të regjistrohen vetëm në një program studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Pas marrjes së dokumentacionit dhe regjistrimit të kandidatit, sekretaria mësimore e IAL-së bën regjistrimin *online* në portalin U-Albania. Kandidatët dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) kopje e dokumentit të identifikimit;
  - b) kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës së maturës shtetërore/dëftesës së pjekurisë ose të një diplome studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehsuar nga QSHA, së bashku me certifikatën përkatëse të notave;
  - c) deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 1, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga kandidati në prani të punonjësit të sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet prej tyre.
  - d) formulari i aplikimit sipas shtojcës nr. 2 pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Sekretaritë mësimore mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të kandidatit kryhet regjistrimi *online* në Portalin U-Albania. Në fund të procedurës, kandidati dhe punonjësi i sekretarisë mësimore firmosin në dy kopje formularin e printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet kandidatit.

### **KREU IV PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR TRANSFERIM TË STUDIMEVE DHE PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**



1. Kandidati që kërkon të ndjekë studimet në një program të dytë studimi apo të transferojë studimet në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ka të drejtë të aplikojë pranë institucioneve të arsimit të lartë, sipas afateve të përcaktuar në kalendar.
2. Kandidati aplikon në IAL për program të dytë studimi apo transferim studimesh, deri në 5 (pesë) programe studimi.
3. Kandidati që aplikon për transferim studimesh plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin përkatës akademik në të cilin është regjistruar në IAL.
4. Nuk mund të pranohen aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Kandidati që aplikon për transferim të studimeve apo për program të dytë studimi duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit për të cilët aplikon me përjashtim të nxënësve ose studentëve të shkëlqyer. Kandidati nuk duhet të jetë duke ndjekur një tjetër program studimi.
5. Aplikimi për transferim studimesh, mund të bëhet nga një program studimi i licencuar dhe akredituar, i njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtit cikël, i ndjekur nga kandidati në IAL vendase apo të huaja. Në këtë kuadër nuk mund të kryhen transferime studimesh ndërmjet programet të studimeve dyvjeçare me karakter profesional, programeve të studimeve të ciklit të parë dhe në programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë.
6. Kandidati që aplikon për transferim të studimeve, paraqet, pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programet përkatës të studimeve, dokumentet si më poshtë:
  - a) Formulari i aplikimit sipas shtojcës nr. 3, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi;
  - b) deklaratën sipas shtojcës nr. 1, të këtij udhëzimi;
  - c) planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse. Studenti që transferon studimet nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, dorëzon të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin planin e plotë të programit të studimit përfshirë syllabuset përkatëse si dhe listën e notave me kreditet e fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer;
  - d) vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;
  - e) kopje të njësuar me origjinalin të diplomës së Maturës Shtetërore/dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme për kandidatin që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011;
  - f) kopje të dokumentit të identifikimit;
  - g) dy fotografi personale;
  - h) kopje të mandatpagesës.
7. Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në IAL (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet edhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:
  - a) Emrin, atësinë, mbiemrin;
  - b) datëlindjen;
  - c) vendlindjen;
  - d) shtetësinë;

- e) numrin e matrikullimit që ka pasur në IAL-në përcjellëse;
  - f) emrin e institucionit të arsimit parauniversitar të mesëm të lartë/IAL-së ku ka kryer studimet përpara ndjekjes së këtij programi studimi;
  - g) ID-në e Maturës Shtetërore / nr. Regj. të veçantë<sup>1</sup>;
  - h) numrin personal të identitetit;
  - i) datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja;
  - j) emërtimin e programit të studimit dhe fakultetit përkatës;
  - k) ciklin dhe formën e studimit;
  - l) datën e ndërprerjes së studimeve.
8. Kandidati që aplikon për program të dytë studimi paraqet dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin përkatës të studimeve:
- a) formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 3, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi;
  - b) deklaratën sipas shtojcës nr. 1, të këtij udhëzimi;
  - c) kopje të njehsuar me origjinalit të diplomës dhe listën e notave/suplementin e diplomës, të studimeve të arsimit të lartë të kryera më parë;
  - d) vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse);
  - e) kopje e njësuar me origjinalin e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme (për kandidatin që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011). Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në DRAP/ZVAP përkatëse si dhe listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;
  - f) kopje të dokumentit të identifikimit;
  - g) dy fotografi personale.
9. Kandidatët fitues me diplomë të huaj, në këto programe studimi, i nënshtrohen procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, si të gjithë kandidatët e tjerë, por regjistrimi i këtyre kandidatëve fitues bëhet me rezervë, pa pasur domosdoshmërisht në momentin e regjistrimit dokumentin e njohjes dhe njësimit të lëshuar nga QSHA.
10. IAL-të shpallin në vende të dukshme listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi, brenda datës së përcaktuar në kalendar.
11. Çdo aplikim për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohet nga komisioni i ngritur për këtë qëllim nga IAL-ja, brenda datës së përcaktuar në kalendar. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi. Të dhënat e të gjithë kandidatëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit shpallen në mjediset e fakultetit të IAL-së, si dhe në faqet web përkatëse, e plotësuar sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr. 4, të këtij udhëzimi.

<sup>1</sup> Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme para vitit 2006.



12. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listën me renditjen e kandidatëve brenda datës së përcaktuar në kalendar. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të pranimit për programin përkatës të studimit. Lista përmban pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.
13. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.
14. IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës së përcaktuar në kalendar.
15. Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore sipas afatit të përcaktuar në kalendar, në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara pas vijës së kuqe në listë, brenda datës së përcaktuar në kalendar.

## **KREU V**

### **PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, KANDIDATËVE ME ORIGJINË SHQIPTARE NGA MAQEDONIA E VERIUT, MALI I ZI, PRESHEVA, MEDVEGJA DHE BUJANOVCI, KANDIDATËVE ME STATUSIN E PERSONIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, ME STATUSIN E JETIMIT, SI DHE TË KANDIDATËVE TË PAKICAVE ROME DHE EGJIPTIANE, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

1. Kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e pakicës rome dhe egjiptiane, aplikojnë pranë IAL-ve, sipas kalendarit, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat për këto kategori nga IAL-të në programet e studimit që ato ofrojnë.
2. Kandidatët që aplikojnë në programe studimi për të cilët është parashikuar konkurs pranimi, aplikojnë pranë IAL-ve respektive, deri në datën e përcaktuar në kalendar. Në të njëjtën datë, IAL-të shpallin listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në konkurs, të cilat bëhen publike në mjediset e IAL-ve dhe faqet elektronike zyrtare. Konkurset e pranimit zhvillohen në datën/at e përcaktuar në kalendar.
3. Aplikimi kryhet vetëm nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të lartë dhe plotësojnë:
  - a) kriterin e notës mesatare të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave për vitin përkatës akademik, me përjashtim të kategorive të përjashtuara në këtë vendim;
  - b) kriteret shtesë të pranimit të vendosura nga IAL-të për programet e studimit për të cilët aplikojnë.

4. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.
5. Kandidatët, përpara aplikimit, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilit aplikon.
6. Aplikimi dërgohet me postë pranë sekretarive mësimore ose depozitohet në zyrën e protokollit të njërive kryesore të IAL-ve.
7. Sekretaritë mësimore mbajnë regjistër për aplikimet e depozituara. Me depozitimin e aplikimit, njësitë kryesore përllëgarisin mesataren për çdo kandidat në përputhje me përcaktimet në vendimin e Këshillit të Ministrave për vitin e ri akademik. Kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare njoftohen nga sekretaritë mësimore për ndërprerjen e aplikimit.
8. Kandidatët, në momentin e aplikimit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, dorëzojnë:
    - i. Formularin e aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 2 pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi;
    - ii. deklaratën sipas shtojcës nr. 1, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi;
    - iii. kopje të dokumentit të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që vërteton njohjen e diplomës së arsimit të mesëm të lartë, shoqëruar me kopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave. Kandidatët që nuk e kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit paraqesin vërtetimin që kanë aplikuar pranë QSHA për njohje dhe njehsim të diplomës;
    - iv. kopje të njehsuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë dhe të përkthyer në gjuhën shqipe (nëse është lëshuar në gjuhë të huaj) të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet.
    - v. dokument identifikimi;
    - vi. dy fotografi;
    - vii. kopje të mandatpagesës.
  - b) Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e pakicës rome dhe egjiptiane, dorëzojnë:
    - i. Formularin e aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 2, të këtij udhëzimi.
    - ii. kopje të diplomës/dëftesës, të shoqëruar me listën e notave;
    - iii. në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-së, deklaratën sipas shtojcës nr. 1, të këtij udhëzimi si dhe kopje të njësuar me origjinalin, të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë kopje të njësuar me origjinalin e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme;
    - iv. kopje të dokumentit të identifikimit;
    - v. dy fotografi personale;
    - vi. kopje të mandatpagesës;



- c) Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8 të këtij kreu, duhet të dorëzojë kopje të njehsuar me origjinalin të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) ose kopje të njehsuar me origjinalin të librezës përkatëse të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;
  - d) kandidati me statusin e jetimit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8 të këtij kreu, duhet të dorëzojë edhe kopje të njehsuar me origjinalin të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;
  - e) kandidati që i përket pakicave rome apo egjiptiane, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8, të këtij kreu duhet të dorëzojë edhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton përkatësinë në pakicën rome apo egjiptiane.
9. Kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, i nënshtrohen procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, sipas afateve të përcaktuara në këtë kre. Por, regjistrimi si student i këtyre kandidatëve fitues mund të bëhet me rezervë, nëse në momentin e regjistrimit nuk zotërojnë dokumentin e njohjes dhe njësimin të lëshuar nga QSHA.
  10. IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kritereve të përcaktuara nga ana e tyre dhe publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes për çdo program studimi që ofrojnë. Gjithashtu, IAL-të në datën e përcaktuar në kalendar publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre elektronike zyrtare listën paraprake të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
  11. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.
  12. IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën e përcaktuar në kalendar, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
  13. Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës së përcaktuar në kalendar.
  14. Pas datës së përcaktuar në kalendar, sekretaritë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve, për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.
  15. IAL-të brenda datës së përcaktuar në kalendar, përfundojnë regjistrimin e kandidatëve fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit.

## **KREU VI**

### **PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE ME DIPLOMË TË HUAJ TË SHKOLLËS SË MESME, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**



1. Të gjithë kandidatët me diplomë të huaj të arsimit të mesëm të lartë, që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në IAL, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, sipas afateve të përcaktuara nga IAL-të, për çdo vit akademik, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat për këto kategori nga IAL-të në programet e studimit që ato ofrojnë.
2. Kandidatët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe të jenë të pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor, nuk duhet të rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara nga IAL-të, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.
3. Kandidatët, i nënshtrohen procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, sipas afateve të përcaktuara në këtë kre. Regjistrimi i këtyre kandidatëve fitues bëhet me rezervë, nëse në momentin e regjistrimit nuk zotërojnë dokumentin e njohjes dhe njehsimit të lëshuar nga QSHA.
4. Kandidatët, përpara aplikimit kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilit aplikojnë.
5. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.
6. Kandidatët duhet të paraqesin pranë IAL-ve dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 2, të këtij udhëzimi;
  - b) kopje të dokumentit të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që vërteton njohjen e diplomës së arsimit të mesëm të lartë, shoqëruar me kopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave. Kandidatët që nuk e kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit paraqesin vërtetimin që kanë aplikuar pranë QSHA për njohje dhe njehsim;
  - c) kopjen e dokumentit të identifikimit;
  - d) dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe). Kandidatët që kanë kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë;
  - e) dy fotografi personale;
  - f) kopjen e mandatpagesës;
  - g) deklaratën sipas shtojcës nr. 1, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi.
7. Kandidatët paraqesin aplikimin e tyre pranë IAL-se përkatëse. Pas zhvillimit të konkurseve/testimeve të pranimit, IAL-ja i dërgon QSHA-së listat e fituesve dhe të dhënat e tyre, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të nevojshëm.
8. Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në të njëjtën gjuhë të huaj që zhvillohet edhe programi i studimit i IAL-së ku aplikon, përjashtohen nga detyrimi i paraqitjes së dëshmisë së njohjes së kësaj gjuhe të huaj.



9. IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të publikojnë në mjediset të dukshme dhe faqen e tyre elektronike zyrtare listën paraprake të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
10. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.
11. IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
12. Kandidatët regjistrohen vetëm në një nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës së përcaktuar nga IAL. Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të heqë dorë për t'u regjistruar në një program tjetër studimi.
13. Sekretaritetë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.
14. Sekretaritetë mësimore të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.

## **KREU VII**

### **PRANIMET NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE”**

1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë, me përjashtim të programeve të integruara të ciklit të dytë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, për çdo vit akademik të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësisë kryesore, në IAL, në datat e përcaktuara në kalendar.
2. IAL-të shpallin publikisht kriteret e pranimit, hapjen e procedurave të aplikimit, afatet e konkurrimit dhe të regjistrimit, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si dhe informacione të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-ve.
3. Brenda afateve IAL-të, afishojnë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësisë kryesore përkatëse, si dhe në faqet elektronike zyrtare (web) të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga kandidatët, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara.

4. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda 3 (tre) ditëve nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.
5. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve sipas kalendarit.
6. IAL shpall në vende të dukshme dhe publikon edhe në faqen e saj elektronike zyrtare (web), listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datave përkatëse të përcaktuara në kalendar.
7. Njësitë kryesore të IAL-ve, organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve dhe verifikimin e dokumentacionit të pranimit sipas kuadrit ligjor në fuqi.
8. Pranimi në programet e studimit të ciklit të dytë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve”, sipas kuotave respektive të pranimit realizohet në bazë të përzgjedhjes, në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kritereve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht.
9. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë, kandidatët që:
  - a) Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit, dhe akredituar para diplomimit të studentit, ose;
  - b) janë diplomuar jashtë vendit në një institucion të arsimit të lartë ose institucion tjetër të autorizuar të huaj, të akredituar, për një program studimi të ciklit të parë, të akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njohjen dhe njehsimin e diplomës pranë QSHA, sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.
10. Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) Diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës, ose kopje të saj të njehsuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomë të ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me kopje të diplomës të njehsuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njohja dhe njehsimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë. Kandidatët që nuk e kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit të diplomës, paraqesin vërtetimin që kanë aplikuar pranë QSHA për njohje dhe njehsim;
  - b) formularin e aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 2, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi;
  - c) deklaratën sipas shtojcës nr. 1, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi;
  - d) kopjen e dokumentit të identifikimit;
  - e) dy fotografi personale;
  - f) dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse, vetëm për shtetasin e huaj i cili regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe. Kandidati që ka kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të paraqesë çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e kësaj gjuhe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e



huaj që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë ose program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

- g) Kandidatët e kategorive të veçanta, përveç dokumenteve të kërkuara më sipër, dorëzojnë:
- i. Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar duhet të dorëzojë dhe kopjen e njësuar me origjinalin të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të KMCAp-së;
  - ii. kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe kopjen e njësuar me origjinalin të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;
11. Kandidati i pakicës rome apo egjiptiane, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që i përket kësaj pakice.
12. Pranë departamenteve të njësisve kryesore të IAL-ve ngrihen komisione *ad hoc* sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.
13. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit.
14. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA pas verifikimit i bën me dije IAL-ve mbi mospajisjen me numër matrikullimi dhe i kërkon çregjistrimin e studentit.

## **KREU VIII**

### **PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR TRANSFERIM TË STUDIMEVE OSE PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI, NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

1. Kandidatët që kërkojnë të transferojnë studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve apo të ndjekin një program të dytë studimi, me përjashtim të programeve të integruara të studimit, aplikojnë pranë IAL-ve, në datat e përcaktuara në kalendar.
2. Kandidatët që aplikojnë në IAL, për transferim studimesh apo për program të dytë studimi kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 (pesë) programe studimi përpara fillimit të vitit akademik.
3. Kanë të drejtë të aplikojnë për transferim studimesh në programet e ciklit të dytë të gjithë kandidatët që:
  - a) Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë të studimeve, si dhe ndjekin një program studimi të ciklit të dytë në momentin e transferimit;

- b) janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë të studimeve, si dhe ndjekin një program studimi të ciklit të dytë në momentin e transferimit. Kandidati është i detyruar të kryejë njohjen dhe njehsimin e diplomës pranë QSHA brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.
4. Transferimi i studimeve në ciklin e dytë të studimeve mund të bëhet në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtit cikël sipas kritereve të vendosura dhe shpallura publikisht paraprakisht nga IAL.
5. Transferimi i studimeve kryhet në zbatim të procedurave të përcaktuara sipas afateve të parashikuara në kalendar.
6. Aplikojnë në programet e ciklit të dytë për program të dytë studimi, kandidatët që:
- a) Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të dytë të studimit, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit dhe i akredituar para diplomimit të studentit; ose
- b) janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të dytë të studimit. Kandidati është i detyruar të kryejë njohjen dhe njehsimin e diplomës pranë QSHA, brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.
7. Kandidati që aplikon për transferim në ciklin e dytë të studimeve paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij në IAL dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) Diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës ose kopje të saj të njehsuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve. Diploma e ciklit të parë e fituar jashtë vendit shoqërohet me aktin e njohjes dhe njehsimit të lëshuar nga QSHA ose kopje të tij të njehsuar me origjinalin.
- b) diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose kopje të tyre të njehsuar me origjinalin, e konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar”, paraqesin dëftesën e pjekurisë (origjinal ose kopje të njehsuar me origjinalin, të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave;
- c) formularin i aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 3, të këtij udhëzimi;
- d) kopjen e dokumentit të identifikimit;
- e) dy fotografi personale;
- f) dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse për shtetasin e huaj i cili regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe. Kandidati që ka kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të paraqesë çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e kësaj gjuhe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që



- kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.
- g) deklaratën sipas shtojcës nr. 1, të këtij udhëzimi;
  - h) dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL nga i cili transferohet, që përmban:
    - i) Emrin, atësinë, mbiemrin;
    - ii) datëlindjen, vendlindjen, shtetësinë;
    - iii) numrat e matrikullimit të programit të studimit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë dhe fakulteteve përkatëse të IAL-së ku ka përfunduar studimet dhe nga ku transferohet;
    - iv) emërtimin e IAL-së dhe të programit të studimit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë dhe forma e studimit;
    - v) datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL nga ku transferohet.
  - i) planin e plotë të programit të studimit nga ku transferohet, vërtetim të listës së notave, krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer në ciklin e dytë të studimeve, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin të lëndëve të programit të studimit të ndjekur, si dhe programeve/syllabuseve përkatëse të lëndëve të shlyera.
8. Kandidati që aplikon për program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij në IAL dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) Diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës, ose kopje të njehsuar me origjinalin, të ciklit të dytë të studimeve. Diploma e ciklit të dytë e fituar jashtë vendit shoqërohet me aktin e njohjes dhe njehsimit të lëshuar nga QSHA ose kopje të tij të njehsuar me origjinalin, brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim;
  - b) Diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës ose kopje të njehsuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve. Diploma e ciklit të parë e fituar jashtë vendit shoqërohet me aktin e njohjes dhe njehsimit të lëshuar nga QSHA ose kopje të tij të njehsuar me origjinalin;
  - c) diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose kopje të tyre të njehsuar me origjinalin, e konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar”, paraqesin dëftesën e pjekurisë (origjinal ose kopje të njehsuar me origjinalin, të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave;
  - d) formularin i aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 3, të këtij udhëzimi;
  - e) kopjen e dokumentit të identifikimit;
  - f) dy fotografi personale;



- g) dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse për shtetasin e huaj i cili regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe. Kandidati që ka kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të paraqesë çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e kësaj gjuhe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar ose arsim të mesëm të lartë ose një program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë;
- h) deklaratën sipas shtojcës nr. 1, të këtij udhëzimi;
- i) plani i plotë i programit të ciklit të dytë të studimeve përfshirë dhe syllabuset përkatëse, vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për njohjen e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse, nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse.
9. Kandidatët e kategorive të veçanta për transferim në ciklin e dytë të studimeve ose për program të dytë në ciklin e dytë, paraqesin dokumentacionin shtesë si më poshtë:
- a) Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar, duhet të dorëzojë edhe kopjen e njehsuar me origjinalin të librezës përkatëse të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të KMCAP-së;
- b) kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe kopjen e njehsuar me origjinalin të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;
- c) kandidati që i përket pakicës rome apo egjiptiane, dorëzon edhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që i përket kësaj pakice.
10. Pranë departamenteve të fakulteteve të IAL-ve ngrihen komisione *ad hoc* sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës së atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet kuadrin ligjor në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave të pranimit për secilin program.
11. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në kalendar. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.
12. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA-ja pas verifikimit i bën me dije IAL-të, mbi mospajisjen me numër matrikullimi dhe i kërkon IAL-së çregjistrimin e studentit.
13. IAL-të shpallin publikisht kriteret e pranimit, hapjen e procedurave të aplikimit, afatet e konkurrimit (në rast se ka) dhe të regjistrimit, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si edhe çdo njoftim tjetër të nevojshëm, për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së.
14. Komisionet respektive kryejnë renditjen e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh apo program të dytë studimi bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, dhe vlerëson kandidatët me statusin fitues/jo fitues. Këto të dhëna shpallen në ambientet e fakultetit dhe IAL-së, si dhe faqet elektronike zyrtare përkatëse (web), të plotësuara sipas tabelave 1a dhe



- 1b, të shtojcës nr. 5, të këtij udhëzimi, respektivisht, për kandidatët që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe për kandidatët që kanë aplikuar për program të dytë studimi.
15. IAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës së përcaktuar në kalendar.
  16. Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës së përcaktuar në kalendar. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, i cili shpallet në mjediset e fakultetit të IAL-së, si dhe faqet elektronike zyrtare përkatëse (web), e plotësuar sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr. 5, të këtij udhëzimi.
  17. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat paraprake me renditjen e kandidatëve brenda datës së përcaktuar në kalendar. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.
  18. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda 3 (tri) ditëve nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.
  19. IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës së përcaktuar në kalendar.
  20. Regjistrimi i kandidatit, i cili mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij, kryhet pranë sekretarive mësimore sipas periudhës së përcaktuar në kalendar. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara pas vijës së kuqe, brenda datës së përcaktuar në kalendar.

## **KREU IX**

### **PRANIMET NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE “MASTER EKZEKUTIV”**

1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të tretë “Master ekzekutiv”, bëhen pranë sekretarive mësimore të njëjësive kryesore, në IAL, sipas afateve të përcaktuara në kalendar.
2. Brenda afateve të përcaktuara në kalendar, IAL shpallin dhe afishojnë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njëjësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet elektronike zyrtare (web) të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga kandidatët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.
3. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda 3 (tri) ditëve nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.
4. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL sipas afateve të përcaktuara në kalendar.
5. IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj elektronike zyrtare (web), listën emërore të kandidatëve të regjistruar sipas afateve të përcaktuara në kalendar.

6. Njësitë kryesore të IAL-ve, organizojnë procesin e pranimit, të regjistrimit të kandidatëve dhe verifikojnë dokumentacionin e pranimit sipas kuadrit ligjor në fuqi.
7. Pranimi, në programet e studimit të ciklit të tretë, “Master ekzekutiv”, sipas kuotave respektive të pranimit, realizohet në bazë të përzgjedhjes në bazë të akteve kuadrit ligjor në fuqi, si dhe kritereve të përcaktuara nga njësitë bazë dhe të bëra publike paraprakisht.
8. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e studimit të ciklit të tretë “Master ekzekutiv”, kandidatët që:
  - a) Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit; ose
  - b) janë diplomuar jashtë vendit në një institucion të arsimit të lartë ose institucion tjetër të autorizuar të huaj, të akredituar, për një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”, i licencuar dhe i akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njësimin dhe njohjen e diplomës pranë QSHA-së brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.
9. Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) Diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës, ose kopje të saj të njehsuar me origjinalin, të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave”/ “Master i arteve” të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave”/“Master i arteve” të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me kopje të diplomës të njehsuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njehsimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve të arsimit të lartë të ciklit të tretë në vendin përkatës;
  - b) vërtetimin për njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, përmes testeve të njohura ndërkombëtare, sipas nivelit të përcaktuar me aktin nënligjor të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
  - c) Formularin e aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 2, të këtij udhëzimi;
  - d) kopjen e dokumentit të identifikimit;
  - e) dy fotografi personale
  - f) Curriculum Vitae;
  - g) kopje e njehsuar me origjinalin e librezës së punës.
  - h) për shtetasit e huaj dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse, i cili regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe. Kandidati që ka kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të paraqesë çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e kësaj gjuhe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.



- i) Deklaratën sipas, shtojcës nr. 1, të këtij udhëzimi.
10. Kandidatët e kategorive të veçanta për aplikimin për program studimi të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, paraqesin dokumentacionin shtesë si më poshtë:
- a) Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar, dorëzon edhe kopjen e noterizuar të librezës përkatëse të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të njehsuar me origjinalin të vendimit të KMCAP-së;
  - b) kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe kopjen e njehsuar me origjinalin të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;
  - c) kandidati që i përket pakicës rome apo egjiptiane, dorëzon edhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që i përket kësaj pakice.
11. Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione *ad hoc* sipas fushave përkatëse, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës së kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi, si dhe kriteret e deklaruara paraprakisht nga IAL-ja për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse.
12. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në kalendar. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.
13. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA-ja pas verifikimit i bën me dije IAL-të mbi mospajisjen me numër matrikullimi.
14. IAL-të shpallin publikisht kriteret e pranimin, hapjen e procedurave të aplikimit, afatet e konkurrimit (në rast se ka) dhe të regjistrimit, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si edhe çdo njoftim tjetër të nevojshëm, për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së.

## **KREU X**

### **DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI**

1. IAL-të dorëzojnë listat e studenteve në QSHA, përfshirë edhe ata të regjistruar me rezervë, në formë shkresore dhe elektronike sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për arsimin për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit, sipas afateve të mëposhtme:
- a) brenda datës 30 nëntor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve;
  - b) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar me transferim studimesh dhe program të dytë studimi në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve;
  - c) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me



- statusin e jetimit, si dhe të studentëve që i përkasin pakicës rome dhe egjiptiane në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve;
- d) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve me diplomë të huaj, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve,
  - e) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të dytë të studimeve, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve”.
  - f) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar me transferim studimesh dhe program të dytë studimi në programet e ciklit të dytë të studimeve,
  - g) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të tretë të studimeve, “Master ekzekutiv”.
2. Për kandidatët e regjistruar me rezervë në një program studimi të arsimit të lartë, të cilët kanë detyrimin njohjen dhe njësimin e diplomës përkatëse, IAL-të përcjellin në QSHA brenda datës 30 prill të çdo viti akademik, dokumentet e njohjes dhe njësimit të diplomave të tyre, të lëshuara nga QSHA. QSHA e pajis me numër matrikulli përpara fillimit të sezonit të dytë të provimeve.
  3. Për të gjithë kandidatët e përcjellë pas afateve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij kreu ose që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi, QSHA nuk do të procedojë me dhënien e numrave të matrikullimit. Në këto raste, QSHA njofton IAL-të brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve dhe i kërkon çregjistrimin e kandidatit. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i QSHA-së, IAL njofton kandidatin për arsyet e mosmatrikullimit dhe kryen çregjistrimin e tij, si dhe njofton me shkresë zyrtare, brenda 7 (shtatë) ditëve njofton QSHA-në për çregjistrimin e tij.
  4. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme, kandidati duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore të lëshuar nga QSHA dhe dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga institucioni i arsimit të mesëm të lartë dhe të vërtetuar në DRAP/ZVAP përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit.
  5. Kandidatët e shpallur fitues në programet e të gjitha cikleve të studimit nuk mund të regjistrohen për të ndjekur njëkohësisht dy programe studimi në IAL-të, në të njëjtin vit akademik, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.
  6. IAL-të përpilojnë një raport të hollësishëm në lidhje me regjistrimet e studentëve në afatet dhe formatet e kërkuara sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për arsimin që përcakton elementët përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë. Ky raport dërgohet në MAS brenda datës 31 dhjetor të çdo viti akademik.
  7. Përjashtimisht, urdhri i përbashkët i QSHA dhe RASH për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2023-2024, miratohet në muajin korrik 2023.
  8. Udhëzimi nr. 10, datë 15.5.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, shfuqizohet.



9. Ngarkohen Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar për miratimin e kalendarit, për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit, për çdo vit akademik, si dhe publikimit të tij brenda muajit qershor të çdo viti kalendarik.
9. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI**

**EVIS KUSHI**



## SHTOJCA NR. 1

### DEKLARATË

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, (emri atësia mbiemri) lindur më \_\_\_\_\_ me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë \_\_\_\_\_ ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve të arsimit të lartë në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventuale të tyre. Autorizoj, gjithashtu Institucionin e Arsimit të Lartë ku kam aplikuar, ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet e arsimit të lartë, ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.
2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.
3. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord.
4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe/ose institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventalisht edhe organeve kompetente.

\_\_\_\_\_  
Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Firma:

Vendi: \_\_\_\_\_



Data: \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

**Formular aplikimi**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_  
emri atësia mbiemri  
me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_

e-mail: \_\_\_\_\_, Tel: \_\_\_\_\_

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit: (të shënohet me "x" përzgjedhja e kandidatit)

- Me karakter profesional (1 ose 2 vjeçar)
- "Bachelor"
- Integruar i ciklit të dytë "Master i shkencave"
- "Master profesional"
- "Master i shkencave"/ "Master i arteve"
- "Master Ekzekutiv"

\_\_\_\_\_ në IAL \_\_\_\_\_

1. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët:

a) shtetas shqiptarë brenda vendit

b) me kombësi shqiptare nga trojet (të shënohet me "x" vendi nga vjen kandidati):

- Republika e Kosovës;
- Mal i Zi;
- Maqedonia e Veriut;
- Preshevë;
- Bujanovci;
- Medvegja;

c) me diplomë të huaj

Me shtetësi \_\_\_\_\_

Gjuhë amtare \_\_\_\_\_

Me arsim të mesëm \_\_\_\_\_

Adresë aktuale \_\_\_\_\_

2. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (të shënohet me "x" kategoria):

- PAK
- jetim;
- Pakica Rome;
- Pakica Egjiptiane.

3. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë të sipërcituar dhe institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve të arsimit të lartë, në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

4. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në njërin nga programet e studimit në të cilin do të shpallej fitues për vitin akademik në vijim.

5. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

6. Deklaroj se jam njohur me udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.

7. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, institucioni përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

*Emër, atësi, mbiemër i kandidatit*

*Firma*



**Formular aplikimi për transferim studimesh ose program të dytë studimi**

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_  
emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_ e-mail:  
\_\_\_\_\_, Tel: \_\_\_\_\_

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit (vendosni një rreth):

- me karakter profesional 2 – vjeçar
- ciklit të parë “Bachelor”
- integruar të ciklit të dytë
- ciklit të dytë “Master profesional”
- ciklit të dytë “Master i shkencave” / “Master i arteve”

në \_\_\_\_\_, në IAL \_\_\_\_\_

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (të shënohet me “x” vendi nga vjen kandidati):

**A. Për program të dytë studimi**

**B. Për transferim studimesh**

1. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët:

a) shtetas shqiptarë brenda vendit

b) me kombësi shqiptare nga trojet (të shënohet me “x” vendi nga vjen kandidati):

- Republika e Kosovës;
- Mal i Zi;
- Maqedonia e Veriut;
- Preshevë;
- Bujanovci;
- Medvegja;

b) me diplomë të huaj

Me shtetësi \_\_\_\_\_

Gjuhë amtare \_\_\_\_\_

Me arsim të mesëm \_\_\_\_\_

Adresë aktuale \_\_\_\_\_

2. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (të shënohet me “x” kategoria):

- PAK

- jetim;
- Pakica Rome;
- Pakica Egjiptiane.

3. Deklaroj se jam njohur me parashikimet e udhëzimit të ministrit përgjegjës për arsimin për pranimet në ciklin përkatës të studimit.

4. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shtesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të IAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.

5. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë dhe institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

6. Autorizoj, gjithashtu, Institucionin e Arsimit të lartë dhe institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.

5. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, institucioni përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

---

Emër atësi mbiemër i kandidatit

Firma

---

Emër, atësi, mbiemër i punonjësit që pranoi aplikimin

Firma



**SHTOJCA NR. 4**

*Tabela 1a. Të dhënat e të gjithë kandidatëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.*

	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit të kryer më parë dhe lloji ("Bachelor", PICD)	IAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të studimit	Data e diplomimit në programin e parë të studimit	Emërtimi i programit të studimit ku aplikon për program të dytë dhe lloji ("Bachelor", PICD)	Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit Fines/Jo fines	
											Kriteri 1	Kriteri 2	....	Pikët totale		
1																
2																
3																
....																

Tabela 1b. Të dhënat e të gjithë kandidatëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalencimit dhe vlerësimit.

nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit nga transferohet dhe lloji (Bachelor, PICD)	IAL-ja nga transferohet	Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik parardhës	Kreditet (ECTS) të grumbulluara nga kandidati	Emërtimi i programit të studimit nga transferohet dhe lloji (Bachelor, PICD)	Viti i studimit ku transferohet	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit Fitness/Jo fitness
												Kriteri 1	Kriteri 2	eti	Pikët totale	



## SHTOJKA NR. 5

Tabela 1a. Të dhënat e të gjithë kandidatëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga i ransferohet dhe lloji	IAL-ja nga transferohet	Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik parardhës	Kreditet (ECTS) të grumbulluara nga kandidati	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga transferohet dhe lloji	Viti i studimit ku transferohet	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit Fines/Jo fines
												Kriteri 1	Kriteri 2	....	Pikët totale	
1																
2																
3																
....																

Tabela 1b. Të dhënat e të gjithë kandidatëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalencimit dhe vlerësimit.

nr.	Emër	Adresi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) të kryer më parë dhe lloji	IAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të studimit	Data e diplomimit në programin e parë të studimit	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) ku aplikon për program të dytë dhe lloji	Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit Fitues/Jo fitues	
											Kriteri 1	Kriteri 2	....	Pikët totale		
1																
2																
.....																